



Prishtinë: 24.03.2010

Kodi i ZRRE-së: V\_233\_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_328\_02\_10

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_328\_02\_10** ;
5. Apeli i konsumatorit me datë 24.02.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë; dhe
7. Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës Nr. 02/L-47

**Në mbledhjen e mbajtur më 24 mars 2010 nxori këtë:**

### VENDIM

**REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Bedrije Kllokoqi (shifra e konsumatorit DPR – 14698) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së me datë 10.12.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 30.11.2009, lidhur me kontestimin për parapagimin për RTK.

- Me datë 29.10.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar parapagimin për RTK.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 30.11.2009 Departamenti për Konsumator iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar e duke u thirrur në Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2003/12.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 30.11.2009
- Me datë 10.12.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së.
- Me datë 11.02.2010 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë një vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se konsumatori nuk ka plotësuar asnjë kriter të paraqitur në nenin 20.3 dhe 20.9 të Ligjit Nr. 02/L-47 të Radio Televizionit të Kosovës.  
**Provë:** Vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_328\_02\_10

- Me datë 21.12.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_328\_02\_10.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në Bord të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK\_V\_328\_02\_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimin të këtij Vendimi.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar